



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**RREGULLORE (ZKM) NR. 22/2024 PËR ORGANIZIMIN E  
BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS  
NË AGJENCINË E KOSOVËS PËR FORENZIKË<sup>1</sup>**

---

<sup>1</sup> Rregullorja (ZKM) Nr. 22/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, është miratuar nga Kryeministri, me Vendimin Nr. 200/2024, të datës 26.12.2024.

**Kryeministri i Republikës së Kosovës,**

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 28 (3) të Ligjit Nr. 06/L- 113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr.7, 01 mars 2019), nenit 12 të Ligjit Nr. 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë (Gazeta Zyrtare Nr. 25, të datës 14.11.2011) dhe nenit 9, paragrafin 7 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura,

Nxjerr:

**RREGULLORE (ZKM) NR. 22/2024 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË AGJENCINË E KOSOVËS PËR FORENZIKË**

**KAPITULLI I  
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Qëllimi**

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.

**Neni 2  
Fushëveprimi**

1. Kjo Rregullore zbatohet nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë janë të përcaktuara me Ligjin përkatës për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë dhe legjislacionin tjetër përkatës në fuqi.

**Neni 3  
Përkufizimet**

1. Shprehjet, termat dhe shkurtesat e përdorura në këtë Rregullore, kanë kuptimin si në vijim:
  - 1.1. **AKF** – nënkupton Agjencia e Kosovës për Forenzikë;
  - 1.2. **ILECU** – nënkupton Drejtoria për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Fushën e Zbatimit të Ligjit;
  - 1.3. **IBIS** – nënkupton Sistemi i Integruar për Identifikime Balistike;

- 1.4. **EVOFINDER** – nënkupton Sistemi për Identifikime Balistike;
  - 1.5. **AFIS** – nënkupton Sistemi për Identifikim Automatik të Gjurmëve të Gishtave;
  - 1.6. **LIMS** – nënkupton Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Laborator;
  - 1.7. **CODIS** – nënkupton Baza e të Dhënave e Profileve të ADN-së të rasteve kriminale;
  - 1.8. **LIVE ID** – nënkupton Sistem i Identifikimit të Drejtpërdrejt përmes sistemit AFIS;
  - 1.9. **KEESING** – nënkupton Baza e të Dhënave me përshkrim të tipareve të sigurisë/mostra standarde për krahasim për dokumente dhe kartëmonedha;
  - 1.10. **C5A** - nënkupton Baza e të Dhënave e Komisionit Evropian për klasifikimin e falsifikimeve të monedhave euro;
  - 1.11. **ADN** – nënkupton Acidi dezoksiribonukleik.
2. Shprehjet, termat dhe shkurtesat e tjera të përdorura në këtë Rregullore, kanë kuptimin e njëjtë me shprehjet e përdorura në Ligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.

## **KAPITULLI II ORGANIZIMI I BRENDSHËM I AGJENCISË SË KOSOVËS PËR FORENZIKË**

### **Neni 4 Misioni i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë**

Misioni i Agjencisë është ofrimi i shërbimeve cilësore forenzike, në përputhje me legjisllacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare.

### **Neni 5 Struktura organizative e Agjencisë**

1. Struktura organizative e Agjencisë është si vijon:
  - 1.1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv;
  - 1.2. Departamentet, dhe
  - 1.3. Divizionet.
2. Numri i të punësuarve në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë është pesëdhjetë e tetë (58).

### **Neni 6 Zyra e Drejtorit Ekzekutiv**

1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv përbëhet nga:

- 1.1. Drejtori Ekzekutiv;
  - 1.2. Zyrtari i Lartë Ekzekutiv, dhe
  - 1.3. Zyrtari i Lartë për Burime Njerëzore.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv përcaktohen me Ligjin përkatës për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Ligjin përkatës për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.
  3. Detyrat dhe përgjegjësitë e nëpunësve civil të Zyrës së Drejtorit Ekzekutiv, përcaktohen me legjislacionin për zyrtarët publik dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
  4. Numri i të punësuarve në Zyrën e Drejtorit Ekzekutiv është tre (3).

## **Neni 7**

### **Departamentet dhe divizionet e Agjencisë**

1. Departamentet dhe divizionet e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, janë:
  - 1.1. Departamenti i Forenzikës Krahasimore, me divizionet si në vijim:
    - 1.1.1. Divizioni për Ekspertizë të Dokumenteve, Dorëshkrimeve dhe Parasë;
    - 1.1.2. Divizioni për Ekspertizë të Gjurmëve të Gishtave;
    - 1.1.3. Divizioni për Ekspertizë Balistike;
    - 1.1.4. Divizioni për Ekspertizë të Gjurmëve Traseologjike;
    - 1.1.5. Divizioni për Ekspertizë Financiare.
  - 1.2. Departamenti i Forenzikës Analitike, me divizionet si në vijim:
    - 1.2.1. Divizioni për Ekspertizë të Serologjisë dhe ADN-së;
    - 1.2.2. Divizioni për Ekspertizë të Narkotikëve;
    - 1.2.3. Divizioni për Ekspertizë të Eksplozivëve, Grimcave të Barutit dhe Zjarrvënieve.
  - 1.3. Departamenti i Forenzikës së Teknologjisë së Informacionit, me divizionet si në vijim:
    - 1.3.1. Divizioni për Ekspertizë të Forenzikës Digjitale;
    - 1.3.2. Divizioni për Ekspertizë të Forenzikës Multimediale.
  - 1.4. Departamenti për Administrim të Përgjithshëm, me divizionet si në vijim:

1.4.1. Divizioni për Administrimin e Dokumenteve dhe Provave Forenzike;

1.4.2. Divizioni për Logjistikë dhe Teknologji të Informacionit.

## **Neni 8** **Departamenti i Forenzikës Krahasimore**

1. Misioni i Departamentit të Forenzikës Krahasimore është kryerja e ekspertizave kriminalistike nga fusha balistike, traseologjike, daktiloskopike, financiare, ekzaminimin shkencor të dokumenteve, ekzaminimin grafik të dorëshkrimeve dhe të ngjashme.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit të Forenzikës Krahasimore, janë:
  - 2.1. kryerja e ekspertizave balistike, daktiloskopike, traseologjike, financiare, dokumenteve, dorëshkrimeve, monedhave e kartëmonedhave, rikonstruimeve dhe të ngjashme;
  - 2.2. zbatimi i urdhrave të gjykatave, vendimeve të prokurorive dhe përgjigjet në kërkesat e institucioneve të tjera të zbatimit të ligjit;
  - 2.3. regjistrimi, krahasimi i të dhënave të rasteve të sjella për ekspertim në sistemet AFIS, IBIS, EVOFINDER, LIMS dhe dokumente tjera;
  - 2.4. përkujdesja për ruajtjen e integritetit të provave gjatë procesit të ekspertimit;
  - 2.5. asistimi në këqyrjen e vendit të ngjarjes me kërkesën e Prokurorit të Shtetit apo Policisë së Kosovës;
  - 2.6. hartimi i procedurave standarde të përgjithshme të operimit dhe rekomandimi tek Drejtori Ekzekutiv për miratim;
  - 2.7. miratimi i procedurave teknike shkencore të punës së divizioneve të departamentit.
  - 2.8. çdo detyrë tjetër e dhënë me ligj.
3. Në kuadër të Departamentit për Forenzikë Krahasimore, bëjnë pjesë divizionet si në vijim:
  - 3.1. Divizioni për Ekspertizë të Dokumenteve, Dorëshkrimeve dhe Parasë;
  - 3.2. Divizioni për Ekspertizë të Gjurmëve të Gishtave;
  - 3.3. Divizioni për Ekspertizë Balistike;
  - 3.4. Divizioni për Ekspertizë të Gjurmëve Traseologjike;
  - 3.5. Divizioni për Ekspertizë Financiare;
4. Drejtori i Departamentit raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë.

5. Numri i të punësuarve në Departamentin për Forenzikë Krahasimore është njëzet e gjashtë (26).

## **Neni 9**

### **Divizioni për Ekspertizë të Dokumenteve, Dorëshkrimeve dhe Parasë**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Ekspertizë të Dokumenteve, Dorëshkrimeve dhe Parasë, janë:

1.1. ekspertimi i të gjitha llojeve të dokumenteve vendore dhe ndërkombëtare, stampave, vulave të thata dhe me ngjyrë, makinave të shkrimit, dokumenteve të shtypura me makinë shkrimi, bojës/ngjyrës së stilolapsit, dokumenteve të printuara me toner dhe nga inkjet, ekspertimi jo destruktiv i letrës, dorëshkrimeve, nënshkrimeve, gjurmëve të thelluara apo latente të shkrimit, modifikimeve në dokumente, letrave të kopjuara dhe të ngjashme;

1.2. deshifrimi i përmbajtjes së tekstit në dokumente, duke përfshirë edhe në dokumentet e dëmtuara;

1.3. vërtetimi i dokumenteve historike për të përcaktuar autenticitetin e dokumenteve historike të rëndësishme për kulturën dhe trashëgiminë;

1.4. koleksionimi dhe ruajtja e mostrave standarde të dokumenteve, kartëmonedhave dhe monedhave nga shtetet e ndryshme, si dhe krahasimi me bazën e të dhënave “KESSING”;

1.5. koleksionimi i monedhave të falsifikuara dhe klasifikimi i llojeve të falsifikimit sipas bazës së të dhënave C5A të Komisionit Evropian;

1.6. mbajtja e regjistrave të zyrtarëve të autorizuar për nënshkrimin e certifikatave të regjistrimit të automjeteve (CRA) dhe mostrave të vulave për vulojen e CRA-ve në Qendrat e Regjistrimit të Automjeteve në Republikën e Kosovës;

1.7. mbajtja e mostrave të vulave të Policisë së Kosovës në Pikat e Kalimit Kufitar të Kosovës;

1.8. verifikimi dhe kontrollimi i tipareve të sigurisë të mostrave të dokumenteve nga Agjencia e Regjistrimit Civil, Agjencia e Kosovës për Pajisje dhe Produkte Mjekësore si dhe nga institucionet dhe agjencitë e tjera;

1.9. hartimi i procedurave teknike shkencore të punës dhe rekomandimi i tyre për miratim tek Drejtori i Departamentit.

2. Udhëheqësi i Divizionit raporton tek Drejtori i Departamentit.

3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Ekspertizë të Dokumenteve, Dorëshkrimeve dhe Parasë është pesë (5).

**Neni 10**  
**Divizioni për Ekspertizë të Gjurmëve të Gishtave**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Ekspertizë të Gjurmëve të Gishtave, janë:
  - 1.1. ekspertimi i gjurmëve të gishtave, shuplakave të dorës dhe shputave të këmbës;
  - 1.2. administrimi i kartotekës së gjurmëve latente dhe kartelave standarde të gjurmëve të gishtave;
  - 1.3. regjistrimi dhe ruajtja e të dhënave të gjurmëve të gishtave dhe shuplakave të dorës në sistemin AFIS;
  - 1.4. administrimi i sistemit nacional të të dhënave të gjurmëve të gishtave AFIS;
  - 1.5. mirëmbajtja e terminaleve të sistemit AFIS në të gjitha drejtoritë rajonale të Policisë së Kosovës dhe nivelin qendror, si dhe nënsistemit LIVE ID në Pikat e Kalimit Kufitar të Kosovës;
  - 1.6. verifikimi, krahasimi dhe kërkimi i gjurmëve dhe personave në sistemin AFIS sipas kërkesës së Policisë së Kosovës, përkatësisht Drejtorisë së ILECU, FBI-së dhe Agjencive të tjera zbatimit të ligjit;
  - 1.7. përgatitja e gjurmëve të gishtave në formatin e përshtatshëm për tu dërguar për kontrollim dhe verifikim në EUROPOL, INTERPOL dhe shtetet kërkuese;
  - 1.8. hartimi i procedurave teknike shkencore të punës dhe rekomandimi i tyre për miratim tek Drejtori i Departamentit.
2. Udhëheqësi i Divizionit raporton tek Drejtori i Departamentit.
3. Numri i të punësuarve në Divizion për Ekspertizë të Gjurmëve të Gishtave është shtatë (7).

**Neni 11**  
**Divizioni për Ekspertizë Balistike**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Ekspertizë Balistike, janë:
  - 1.1. ekspertimi i armëve të zjarrit dhe pjesëve të tyre, municioneve dhe komponentëve të tyre, gëzhjave, plumbave, zbutësve të zhurmës së armëve, mekanizimit të shkrepjes së armëve;
  - 1.2. përcaktimi i trajektoreve të të shtënave dhe rikonstruimi i të shtënave;
  - 1.3. interpretimi i rezultateve të analizës së grimcave të barotit dhe mënyrës së krijimit të deponimit të tyre;

- 1.4. përcaktimi i distancës së qitjes me metoda kimike;
  - 1.5. çaktivizimi i armëve të zjarrit;
  - 1.6. mbajtja e koleksioneve të armëve të zjarrit dhe municioneve për nevoja të divizionit dhe për referencë;
  - 1.7. regjistrimi dhe ruajtja e të dhënave të rasteve kriminale, armëve të testuara dhe atyre të regjistruara në sistemet IBIS dhe EVOFINDER;
  - 1.8. administrimi i sistemeve nacionale të të dhënave balistike të armëve IBIS dhe EVOFINDER;
  - 1.9. hartimi i procedurave teknike shkencore të punës dhe rekomandimi i tyre për miratim tek Drejtori i Departamentit.
2. Udhëheqësi i Divizionit raporton tek Drejtori i Departamentit.
  3. Numri i të punësuarve në Divizion të Ekspertizës Balistike është shtatë (7).

**Neni 12**  
**Divizioni për Ekspertizë të Gjurmëve Traseologjike**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Ekspertizë të Gjurmëve Traseologjike, janë:
  - 1.1. ekspertimi i veglave dhe gjurmëve të veglave, këpucëve dhe gjurmëve të këpucëve, gomave dhe gjurmëve të gomave, përputhjes fizike të sendeve të thyera dhe shqyera dhe të ngjashme;
  - 1.2. ekspertimi i numrave të karrocërës së automjeteve, restaurimi i numrave serik të dëmtuar në armët e zjarrit dhe të ngjashme;
  - 1.3. ekspertimi i gjurmëve të lëna nga kafshimi dhe të ngjashme;
  - 1.4. hartimi i procedurave teknike shkencore të punës dhe rekomandimi i tyre për miratim tek Drejtori i Departamentit.
2. Udhëheqësi i Divizionit raporton tek Drejtori i Departamentit.
3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Ekspertizë të Gjurmëve Traseologjike është tre (3).

**Neni 13**  
**Divizioni për Ekspertizë Financiare**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Ekspertizë Financiare, janë:
  - 1.1. kryerja e ekspertizave financiare;



- 1.2. analizimi i pasqyrave, kontratave, raporteve financiare, raporteve të kontabilitetit dhe auditimit, kontrolleve financiare dhe të ngjashme;
  - 1.3. analizimi i teknikave të kontabilitetit të kostos, shmangies së tatimeve dhe evazionit fiskal;
  - 1.4. analizimi i koncepteve dhe praktikave të auditimit forenzik dhe të sigurisë;
  - 1.5. vlerësimi dhe mbështetja e koncepteve të kontabilitetit dhe auditimit në lidhje me shkakun e krimit ekonomik;
  - 1.6. hartimi i procedurave teknike shkencore të punës dhe rekomandimi i tyre për miratim tek Drejtori i Departamentit.
2. Udhëheqësi i Divizionit raporton tek Drejtori i Departamentit.
  3. Numri i të punësuarve në Divizion për Ekspertizë Financiare është tre (3).

#### **Neni 14** **Departamenti i Forenzikës Analitike**

1. Misioni i Departamentit të Forenzikës Analitike është kryerja e ekspertizave forenzike nga fusha e serologjisë, analiza të ADN-së, të narkotikëve, të zjarrvënieve, të eksplozivëve, të grimcave të barutit dhe të ngjashme;
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit të Forenzikës Analitike, janë:
  - 2.1. kryerja e ekspertizave dhe analizave serologjike, të ADN-së, të narkotikëve, të zjarrvënieve, të eksplozivëve, të grimcave të barutit dhe të ngjashme;
  - 2.2. regjistrimi, krahasimi i të dhënave të rasteve të sjella për ekspertim në sistemin CODIS;
  - 2.3. zbatimi i urdhrave të gjykatave, vendimeve të prokurorive dhe përgjigjet në kërkesat e institucioneve të tjera të zbatimit të ligjit;
  - 2.4. përkujdesja për ruajtjen e integritetit të provave gjatë procesit të ekspertimit;
  - 2.5. asistimi në këqyrjen e vendit të ngjarjes me kërkesën e Prokurorit të Shtetit apo Policisë së Kosovës;
  - 2.6. hartimi i procedurave standarde të përgjithshme të operimit dhe rekomandimi tek Drejtori Ekzekutiv për miratim;
  - 2.7. miratimi i procedurave teknike shkencore të punës së divizioneve të departamentit.
  - 2.8. çdo detyrë tjetër e dhënë me ligj.
3. Në kuadër të Departamentit për Forenzikë Analitike, bëjnë pjesë divizionet si në vijim:

- 3.1. Divizioni për Ekspertizë Serologjike dhe të ADN-së;
- 3.2. Divizioni për Ekspertizë të Narkotikëve, dhe
- 3.3. Divizioni për Ekspertizë të Eksplozivëve, Grimcave të Barutit dhe Zjarrvënieve.
4. Drejtori i Departamentit raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë.
5. Numri i të punësuarve në Departamentin e Forenzikës Analitike është trembëdhjetë (13).

**Neni 15**  
**Divizioni për Ekspertizë Serologjike dhe të ADN-së**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Ekspertizë Serologjike dhe të ADN-së, janë:
  - 1.1. kryerja e ekspertizave dhe analizave serologjike;
  - 1.2. kryerja e ekspertizave dhe analizave të ADN-së;
  - 1.3. analiza dhe ndërtimi i profileve të ADN-së nga mbetjet mortore dhe krahasimi i tyre me mostrat referente me qëllim identifikimin e personave të zhdukur;
  - 1.4. analiza dhe ndërtimi i profileve të ADN-së dhe krahasimi i tyre për të përcaktuar atësinë dhe amësinë;
  - 1.5. analiza dhe ndërtimi i profileve të ADN-së dhe krahasimi i tyre me qëllim të krijimit të trungut gjenealogjik;
  - 1.6. regjistrimi dhe ruajtja e profileve të ADN-së të rasteve kriminale në sistemin CODIS;
  - 1.7. hartimi i procedurave teknike shkencore të punës dhe rekomandimi i tyre për miratim tek Drejtori i Departamentit.
2. Udhëheqësi i Divizionit raporton tek Drejtori i Departamentit.
3. Numri i të punësuarave në Divizionin për Ekspertizë Serologjike dhe të ADN-së është gjashtë (6).

**Neni 16**  
**Divizioni për Ekspertizë të Narkotikëve**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Ekspertizë të Narkotikëve, janë:
  - 1.1. kryerja e ekspertizave dhe analizave kimike të mostrave të natyrës bimore siç janë kanabisi, kërpudhat, dhe të ngjashme;
  - 1.2. kryerja e ekspertizave dhe analizave kimike të substancave të ndryshme në formë pluhuri, të ngurtë, tablete, kapsule, dhe të ngjashme;

- 1.3. kryerja e ekspertizave dhe analizave kimike të substancave në gjendje të lëngët, viskoze, sintetike dhe të ngjashme;
  - 1.4. mirëmbajta dhe përditësimi i bazës së të dhënave të narkotikëve;
  - 1.5. hartimi i procedurave teknike shkencore të punës dhe rekomandimi i tyre për miratim tek Drejtori i Departamentit.
2. Udhëheqësi i Divizionit raporton tek Drejtori i Departamentit.
  3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Ekspertizë të Narkotikëve është tre (3).

#### **Neni 17**

##### **Divizioni për Ekspertizë të Eksplozivëve, Grimcave të Barutit dhe Zjarrvënies**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Ekspertizë të Eksplozivëve, Grimcave të Barutit dhe Zjarrvënies, janë:
  - 1.1. kryerja e ekspertizave dhe analizave kimike të mbetjeve nga eksplozioni dhe nga mostrat e eksplozivëve, të grimcave të barutit, grimcave nga kapsolla ndezëse e municioneve;
  - 1.2. kryerja e ekspertizave dhe analizave kimike të zjarrvënies nga mostrat e zjarreve të dyshuara;
  - 1.3. mirëmbajta dhe përditësimi i bazës së të dhënave të eksplozivëve dhe zjarrvënies;
  - 1.4. hartimi i procedurave teknike shkencore të punës dhe rekomandimi i tyre për miratim tek Drejtori i Departamentit.
2. Udhëheqësi i Divizionit raporton tek Drejtori i Departamentit.
3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Ekspertizë të Grimcave të Barutit dhe Zjarrvënies është tre (3).

#### **Neni 18**

##### **Departamenti i Forenzikës së Teknologjisë së Informacionit**

1. Misioni i Departamentit të Forenzikës së Teknologjisë së Informacionit është kryerja e ekspertizave forenzike nga fusha e Teknologjisë së Informacionit, sistemet e informacionit, pajisje të telefonisë mobile, mediat e tjera që përmbajnë të dhëna, video incizimeve, audio regjistrime dhe të ngjashme.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit të Forenzikës së Teknologjisë së Informacionit, janë:
  - 2.1. kryerja e ekspertizave nga fusha e forenzikës digjitale dhe forenzikës multimediale;
  - 2.2. mirëmbajtja e sistemeve të informacionit për të siguruar integritetin operacional të proceseve të ekspertizave digjitale dhe multimediale në divizione;

- 2.3. zbatimi i urdhrave të gjykatave, vendimeve të prokurorive dhe përgjigjet në kërkesat e institucioneve tjera të zbatimit të ligjit;
  - 2.4. përkujdesja për ruajtjen e integritetit të provave gjatë procesit të ekspertimit;
  - 2.5. asistimi në këqyrjen e vendit të ngjarjes me kërkesën e Prokurorit të Shtetit apo Policisë së Kosovës;
  - 2.6. hartimi i procedurave standarde të përgjithshme të operimit dhe rekomandimi tek Drejtori Ekzekutiv për miratim;
  - 2.7. miratimi i procedurave teknike shkencore të punës së divizioneve të departamentit;
  - 2.8. çdo detyrë tjetër e dhënë me ligj.
3. Në kuadër të Departamentit për Forenzikë të Teknologjisë së Informacionit, bëjnë pjesë divizionet si në vijim:
    - 3.1. Divizioni për Ekspertizë të Forenzikës Digjitale, dhe
    - 3.2. Divizioni për Ekspertizë të Forenzikës Multimediale.
  4. Drejtori i Departamentit raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë.
  5. Numri i të punësuarve në Departamentin e Forenzikës së Teknologjisë së Informacionit është tetë (8).

## **Neni 19**

### **Divizioni për Ekspertizë të Forenzikës Digjitale**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Ekspertizë të Forenzikës Digjitale, janë:
  - 1.1. kryerja e ekspertizave të forenzikës në fushën e TI-së, krimeve kibernetike të varura nga teknologjia dhe krimeve kibernetike të mundësuar nga teknologjia, sistemeve të informacionit duke përfshirë sistemet kompjuterike, serverët, ruterët dhe të ngjashme.
  - 1.2. analiza dhe nxjerrja e provave digjitale nga sistemet e informacionit, pajisjet e telefonisë mobile, sistemeve cloud të telefonisë mobile, sim kartelat, memori kartelat, pajisjet e navigimit, sistemeve të navigimit të veturave, bazave të të dhënave, sistemeve kompjuterike që janë aktive, pajisjet si dronët dhe pjesët periferike të tyre që përmbajnë informacione;
  - 1.3. mirëmbajtja e sistemeve të informacionit dhe përditësimi i tyre për të siguruar integritetin operacional të proceseve të ekzaminimeve digjitale;
  - 1.4. hartimi i procedurave teknike shkencore të punës dhe rekomandimi i tyre për miratim tek Drejtori i Departamentit.
2. Udhëheqësi i Divizionit raporton tek Drejtori i Departamentit.

3. Numri i të punësuarve në Divizionin e Forenzikës së Teknologjisë së Informacionit është katër (4).

### **Neni 20** **Divizioni për Ekspertizë të Forenzikës Multimediale**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Ekspertizë të Forenzikës Multimediale, janë:
  - 1.1. kryerja e ekspertizave të forenzikës në fushën e TI-së, krimeve kibernetike të varura nga teknologjia dhe krimeve kibernetike të mundësuar nga teknologjia në fushën e regjistrimeve audio-vizuale;
  - 1.2. analiza dhe nxjerrja e audio-regjistrimeve nga sistemet e informacionit;
  - 1.3. analiza dhe nxjerrja e video-regjistrimeve dhe imazhit digjital nga sistemet e informacionit;
  - 1.4. krijimi dhe mirëmbajtja e bazës së të dhënave për audio-regjistrime;
  - 1.5. mirëmbajtja e sistemeve të informacionit dhe përditësimi i tyre për të siguruar integritetin operacional të proceseve të ekzaminimeve digjitale;
  - 1.6. hartimi i procedurave teknike shkencore të punës dhe rekomandimi i tyre për miratim tek Drejtori i Departamentit.
2. Udhëheqësi i Divizionit raporton tek Drejtori i Departamentit.
3. Numri i të punësuarve në Divizionin e Forenzikës Multimediale është tre (3).

### **Neni 21** **Departamenti për Administrim të Përgjithshëm**

1. Misioni i Departamentit për Administrim të Përgjithshëm është të administrojë provat forenzike dhe të ofrojë mbështetje administrative, logjistike dhe shërbime të TI-së për sigurimin e funksionimit të rregullt të AKF-së.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Administrim të Përgjithshëm, janë:
  - 2.1. administrimi dhe regjistrimi i provave forenzike dhe dokumentacionit përcjellës të sjella për ekspertim;
  - 2.2. ofrimi i shërbimeve të përbashkëta logjistike, TI-së për gjithë personelin e AKF-së;
  - 2.3. sigurimi i administrimit të dokumenteve dhe mirëmbajtja e arkivit;
  - 2.4. hartimi i procedurave standarde të përgjithshme të punës dhe rekomandimi i tyre për miratim tek Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë.

2.5. çdo detyrë tjetër e dhënë me ligj.

3. Në kuadër të Departamentit për Administrim të Përgjithshëm, bëjnë pjesë divizionet si në vijim:

3.1. Divizioni për Administrimin e Dokumenteve dhe Provave Forenzike, dhe

3.2. Divizioni për Logjistikë dhe Teknologji Informative.

4. Drejtori i Departamentit për Administrim të Përgjithshëm raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë.

5. Numri i të punësuarve në Departamentin për Administrim të Përgjithshëm është tetë (8).

## **Neni 22**

### **Divizioni për Administrimin e Dokumenteve dhe Provave Forenzike**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizioni për Administrimin e Dokumenteve dhe Provave Forenzike, janë:

1.1. zhvillimi dhe zbatimi i rregullave për shpërndarjen e dokumenteve dhe provave forenzike;

1.2. përkujdesja për ruajtjen e integritetit të provave;

1.3. regjistrimi dhe administrimi i dokumenteve, provave dhe të dhënave në sistemin për menaxhimin e informacionit;

1.4. përgatitja dhe kontrolli i dokumenteve dhe provave forenzike për lëndët që dërgohen për ekspertim/analiza jashtë vendit;

1.5. sistemimi, ruajtja dhe mirëmbajtja e arkivit të lëndëve të ekzaminuara në AKF;

1.6. kontrollimi, mirëmbajtja dhe inventarizimi i dhomës së provave.

2. Udhëheqësi i Divizionit raporton tek Drejtori i Departamentit.

3. Numri i të punësuarve në Divizion për Administrimin e Dokumenteve dhe Provave Forenzike është katër (4).

## **Neni 23**

### **Divizioni për Logjistikë dhe Teknologji të Informacionit**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Logjistikë dhe Teknologji të Informacionit, janë:

1.1. ofrimi i shërbimeve logjistike;

1.2. ofrimi i shërbimeve të transportit dhe mirëmbajtjes së automjeteve të AKF-së;

1.3. mirëmbajtja e pajisjeve të teknologjisë së informacionit, rrjetit dhe softuerëve;

- 1.4. koordinimi i aktiviteteve rreth funksionimin të projekteve të Divizionit për Logjistikë dhe Teknologji të Informacionit, përgatitja e specifikacioneve teknike, mbikëqyrja e punimeve;
  - 1.5. përgatitja e dokumentacionit për projektet, duke përfshirë incizimet, dizajnët inxhinerike ideore dhe detajet, specifikacionet teknike, paramasat dhe parallogaritë, përshkrimet teknike duke respektuar standardet e pranuar vendore dhe ndërkombëtare në lëmin e arkitekturës/makinerisë dhe planifikimit;
  - 1.6. zbatimi i udhëzimeve të Agjencisë Shtetërore të Informacionit për mënyrën e përdorimit të rrjeteve unike qeveritare të komunikimit dhe informatave;
  - 1.7. planifikon dhe përgatit kërkesa për furnizim me pajisje dhe shërbime të TI-së.
2. Udhëheqësi i Divizionit raporton tek Drejtori i Departamentit.
  3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Logjistikë dhe Teknologji të Informacionit është tre (3).

**Neni 24**  
**Funksionet e brendshme mbështetëse**

Shërbimet e auditimit të brendshëm, financave, prokurimit dhe shërbimet ligjore, mbulohen nga njësitë përkatëse të Ministrisë të Punëve të Brendshme.

**KAPITULLI III**  
**DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

**Neni 25**  
**Dispozitat përfundimtare**

1. Lëvizshmëria e personelit në pajtim me legjislacionin për shërbimin civil brenda institucionit është e lejuar, nëse konsiderohet e nevojshme për mbarëvajtjen e punës.
2. Rritja apo zvogëlimi i numrit të personelit në pajtim me Ligjin për Buxhetin Vjetor nuk krijon nevojën e ndryshimit dhe plotësimit të kësaj Rregulloreje, përveç rasteve kur krijohen dhe/apo shfuqizohen strukturat organizative.

**Neni 26**  
**Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja (MPB) Nr. 02/2015 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë.

**Neni 27**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

26 dhjetor 2024



**ORGANOGRAMI I AGJENCISË SË KOSOVËS PËR FORENZIKË (AKF)**

Pozicioni/Struktura	Klasa	Grupi (i përgjithshëm ose i veçantë)	Numri
<b>1. Zyra e drejtorit ekzekutiv në AKF</b>			<b>Totali:3</b>
Drejtori Ekzekutiv	Drejtues i lartë	N/A	1
Zyrtar i Lartë Ekzekutiv	Profesional 1	Grupi i Administrimit të Përgjithshëm	1
Zyrtar i Lartë për Burime Njerëzore	Profesional 1	Grupi i Burimeve Njerëzore.	1
<b>2. Departamenti i Forenzikës Krahasimore</b>			<b>Totali: 26</b>
Drejtor i Departamentit të Forenzikës Krahasimore	Drejtues i mesëm	N/A	1
<b>2.1. Divizioni për Ekspertizë të Dokumenteve, Dorëshkrimeve dhe Parasë</b>			<b>Totali: 5</b>
Udhëheqës i Divizionit për Ekspertizë të Dokumenteve, Dorëshkrimeve dhe Parasë	Drejtues i ulët	N/A	1
Ekspert Forenzik i Dokumenteve, Dorëshkrimeve dhe Parasë	Profesional 1	Grupi i Administrimit të Përgjithshëm	4
<b>2.2. Divizioni për Ekspertizë të Gjurmëve të Gishtave</b>			<b>Totali: 7</b>
Udhëheqës i Divizionit për Ekspertizë të Gjurmëve të Gishtave	Drejtues i ulët	N/A	1
Ekspert Forenzik i Gjurmëve të Gishtave	Profesional 1	Grupi i Sigurisë	6
<b>2.3. Divizioni për Ekspertizë Balistike</b>			<b>Totali: 7</b>
Udhëheqës i Divizionit për Ekspertizë Balistike	Drejtues i ulët	N/A	1

Ekspert Forenzik për Balistikë	Profesional 1	Grupi i Administrimit të Përgjithshëm	6
<b>2.4. Divizioni për Ekspertizë të Gjurmëve Traseologjike</b>			<b>Totali: 3</b>
Udhëheqës i Divizionit për Ekspertizë të Gjurmëve Traseologjike	Drejtues i ulët	N/A	1
Ekspert Forenzik për Gjurmë Traseologjike	Profesional 1	Grupi i Administrimit të Përgjithshëm	2
<b>2.5. Divizioni për Ekspertizë Financiare</b>			<b>Totali: 3</b>
Udhëheqës i Divizionit për Ekspertizë Financiare	Drejtues i ulët	N/A	1
Ekspert Forenzik për Ekspertizë Financiare	Profesional 1	Grupi i Buxhetit dhe Financave	2
<b>3. Departamenti i Forenzikës Analitike</b>			<b>Totali: 13</b>
Drejtor i Departamentit të Forenzikës Analitike	Drejtues i mesëm	N/A	1
<b>3.1. Divizioni për Ekspertizë Serologjike dhe të ADN-së</b>			<b>Totali: 6</b>
Udhëheqës i Divizionit për Ekspertizë Serologjike dhe të ADN-së	Drejtues i ulët	N/A	1
Ekspert Forenzik për Serologji dhe ADN	Profesional 1	Grupi i Shkencave Natyrore	5
<b>3.2. Divizioni për Ekspertizë të Narkotikëve</b>			<b>Totali: 3</b>
Udhëheqës i Divizionit për Ekspertizë të Narkotikëve	Drejtues i ulët	N/A	1
Ekspert Forenzik për Narkotikë	Profesional 1	Grupi i Shkencave Natyrore	2

<b>3.3 Divizioni për Ekspertizë të Eksplozivëve, Grimcave të Barutit dhe Zjarrvëniet</b>			<b>Totali: 3</b>
Udhëheqës i Divizionit për Ekspertizë të Eksplozivëve, Grimcave të Barutit dhe Zjarrvëniet	Drejtues i ulët	N/A	1
Ekspert Forenzik për Eksplozivë, Grimca të Barutit dhe Zjarrvëniet	Profesional 1	Grupi i Shkencave Natyrore	2
<b>4. Departamenti i Forenzikës së Teknologjisë së Informacionit</b>			<b>Totali: 8</b>
Drejtor i Departamentit të Forenzikës së Teknologjisë së Informacionit	Drejtues i mesëm	N/A	1
<b>4.1. Divizioni për Ekspertizë të Forenzikës Digjitale</b>			<b>Totali:4</b>
Udhëheqës i Divizionit për Ekspertizë të Forenzikës Digjitale	Drejtues i ulët	N/A	1
Ekspert Forenzik i TI-së Digjitale	Profesional 1	Grupi i Teknologjisë së të Dhënave	3
<b>4.2. Divizioni i Divizioni për Ekspertizë të Forenzikës Multimediale</b>			<b>Totali: 3</b>
Udhëheqës i Divizionit për Ekspertizë të Forenzikës Multimediale	Drejtues i ulët	N/A	1
Ekspert Forenzik i TI-së Multimediale	Profesional 1	Grupi i Teknologjisë së të Dhënave	2
<b>5. Departamenti për Administrim të Përgjithshëm</b>			<b>Totali: 8</b>
Drejtor i Departamentit për Administrim të Përgjithshëm	Drejtues i mesëm	N/A	<b>1</b>

<b>5.1. Divizioni për Administrimin e Dokumenteve dhe Provave Forenzike</b>			<b>Totali: 4</b>
Udhëheqës i Divizionit për Administrimin e Dokumenteve dhe Provave Forenzike	Drejtues i ulët	N/A	1
Zyrtar i Lartë për Administrimin e Dokumenteve dhe Provave Forenzike	Profesional 1	Grupi i Administrimit të Përgjithshëm	3
<b>5.2 Divizioni për Logjistikë dhe Teknologji të Informacionit</b>			<b>Totali: 3</b>
Udhëheqës i Divizionit për Logjistikë dhe Teknologji të Informacionit	Drejtues i ulët	N/A	1
Zyrtar i Lartë për Teknologji të Informacionit	Profesional 1	Grupi i Teknologjisë Informative	1
Zyrtar për Logjistikë	Profesional 2	Grupi i Administrimit të Përgjithshëm	1
<b>Totali i përgjithshëm i numrit të punësuarve në AKF:</b>			<b>Totali: 58</b>